

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMUNA E VUSHTRRIË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **2026/644-26-4808-1-2-1/B05-0012190**

Sa i përket tenderit për: **Dijitalizimi i sistemit te salles se kuvendit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SMART MODEL LLC

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

KALABRI

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+ 383 (0) 49-19 21 48

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Zymer Veliu Veliu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Smartmodel.rks@gmail.com

(Adresa elektronike)

25.06.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1. Njoftimi për kontrate i datës **18.06.2026**
2. Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje **08.07.2026**
3. Kërkesa për rishqyrtim **22.06.2026**
4. Vendimi refuzues **22.06.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input type="checkbox"/>					Jo	<input checked="" type="checkbox"/>		
----	--------------------------	--	--	--	--	----	-------------------------------------	--	--

Procesverbali i hapjes është pranuar përmes platformës së e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>	
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------	--

Lënda: Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit”, Kodi i procedurës: 2026/644-26-4808-1-2-1/B05-0012190

Ankues:

SMART MODEL LLC, Prishtinë

Kundër:

Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik

Operatori Ekonomik SMART MODEL LLC paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 22.06.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim lidhur me kriteret e dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit “Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit”.

Vlerësojmë se kriteret e kontestuara janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), veçanërisht me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të Rregulloreve të KRPP-se.

SHKELJA E NENIT 25 TË RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te pa kënaqur me përgjigjen e dhënë nga AK-ja në kërkesen për rishqyrtim të datës 22.06.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- **Komuna e Vushtrrisë** në lidhje me aktivitetin e prokurimit: **“Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit”** në afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Për shkak se **AK- Komuna e Vushtrrisë** në përgjigjen e dhënë në kërkesen për rishqyrtim të dhënë vlerësojmë se kriteret e kontestuara janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), veçanërisht me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

I. BAZA LIGJORE

Kjo ankesë parashtrohet në bazë të:

- Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar;
- Nenit 1 të LPP-së – Qëllimi i Ligjit;

- Nenit 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca;
- Nenit 28 të LPP-së – Specifikimet Teknike;
- Nenit 65 të LPP-së – Kriteret e Përzgjedhjes;
- Nenit 69 të LPP-së – Kapaciteti Teknik dhe Profesional;
- Nenit 25.4 dhe 25.6 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik;
- Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik.

II. RRETHANAT FAKTIKE

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Vushtrrisë, ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit:

"Digjitalizimi i sistemit të sallës së kuvendit".

Pas analizimit të Dosjes së Tenderit, operatori ekonomik SMART MODEL LLC ka konstatuar se një numër i konsiderueshëm i kriterëve të kualifikimit profesional, teknik dhe organizativ:

- nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës;
- nuk janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e projektit;
- kufizojnë në mënyrë të panevojshme pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë;
- krijojnë barrierë artificiale për konkurrencën;
- krijojnë dyshim të bazuar se dosja e tenderit është hartuar në mënyrë të tillë që të favorizojë një operator ekonomik të caktuar.

Për këto arsye është ushtruar Kërkesa për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, e cila është refuzuar pa ofruar arsyetim të mjaftueshëm ligjor dhe teknik.

III. SHKELJA E PARIMEVE TË LPP-SË

Sipas nenit 1 të LPP-së, qëllimi i ligjit është:

- përdorimi efikas, efektiv dhe transparent i fondeve publike;
- krijimi i konkurrencës sa më të gjerë ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues i operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë:

- konkurrencë të lirë dhe efektive;
- trajtim të barabartë;
- mosdiskriminim;
- proporcionalitet.

Neni 65 i LPP-së dhe neni 25.6 i Rregullores Nr.001/2022 përcaktojnë qartë se:

Çdo kërkesë minimale për kualifikim duhet të jetë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk gëzon të drejtën të vendosë kërkesa që tejkalojnë nevojat reale të kontratës apo që krijojnë pengesa artificiale për pjesëmarrje.

PRETENDIMI NR. 1

Kërkesa që Menaxheri i Projektit të jetë i certifikuar për punë në lartësi

Autoriteti Kontraktues kërkon që Menaxheri i Projektit:

- të jetë Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës;
- të ketë përvojë profesionale;
- të jetë i certifikuar në programim;
- të jetë i certifikuar për punë në lartësi.

Kjo kërkesë është:

- joproporcionale;
- e panevojshme;
- pa lidhje funksionale me detyrat e Menaxherit të Projektit.

Menaxheri i Projektit ushtron funksione:

- organizative;
- menaxhuese;
- koordinuese;
- mbikëqyrëse.

Ai nuk është personi që domosdoshmërisht kryen punimet fizike në lartësi.

Edhe nëse gjatë realizimit të kontratës paraqiten instalime të kufizuara në lartësi, ato realizohen nga teknikët instalues dhe jo nga Menaxheri i Projektit.

Prandaj, kërkesa për certifikim për punë në lartësi për Menaxherin e Projektit nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

PRETENDIMI NR. 2

Kërkesa që Inxhinieri i Elektroteknikës të jetë i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri

Objekti i kontratës përfshin:

- sistem konferencial;
- sistem audio;
- sistem video;
- sistem votimi elektronik;
- rrjete LAN;
- pajisje IT dhe AV.

Bëhet fjalë kryesisht për sisteme të rrymave të dobëta.

Në dosjen e tenderit nuk është paraparë:

- projektim i sistemeve kundër zjarrit;
- instalim i sistemeve kundër zjarrit;
- mirëmbajtje e sistemeve kundër zjarrit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë arsyetim teknik ose profesional që e bën të domosdoshëm certifikimin AME për mbrojtje nga zjarri.

Prandaj, kjo kërkesë:

- nuk është relevante për objektin e kontratës;
- nuk është proporcionale;
- krijon kufizim artificial të konkurrencës.

PRETENDIMI NR. 3

Kërkesat e tepruara dhe kumulative për personelin profesional

Autoriteti Kontraktues kërkon:

- Inxhinier ose Master të Shkencave Kompjuterike me Licencë A;
- Inxhinier të Elektroteknikës të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe njëkohësisht të certifikuar nga AME;
- Teknik të Elektroteknikës të certifikuar në IT, LAN Architecture dhe Lead Auditor;
- Teknik me certifikatë SIMZ;
- Dy teknikë të certifikuar për Sound System dhe Conference System;
- Person të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë profesionale që dëshmon se secili nga këto certifikime është i domosdoshëm për realizimin e projektit.

Kumulimi i këtyre kërkesave krijon një profil të personalizuar të stafit që në praktikë mund të përmbushet vetëm nga një ose shumë pak operatorë ekonomikë.

Kjo situatë krijon dyshim serioz dhe të arsyeshëm se kriteret janë hartuar për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar, në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

PRETENDIMI NR. 4

Kërkesat e tepruara për certifikime ISO

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

- ISO 9001;
- ISO 14001;
- ISO 20000-1;
- ISO 50001;

- ISO 27001;
- ISO 45001.

Veçanërisht:

ISO 20000-1

është standard për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë informative dhe zakonisht kërkohet për kompani që ofrojnë shërbime të menaxhuara IT në shkallë të gjerë.

ISO 50001

është standard për sistemet e menaxhimit të energjisë.

Asnjëra nga këto certifikime nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e sistemeve audio-vizuale dhe konferenciale.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë arsytim teknik apo profesional që e bën të domosdoshëm posedimin e këtyre standardeve.

Për pasojë, këto kërkesa cenojnë konkurrencën dhe bien ndesh me parimin e proporcionalitetit.

PRETENDIMI NR. 5

KËRKESA DISKRIMINUESE PËR AUTORIZIMIN E PRODHUESIT (MAF)

Autoriteti Kontraktues kërkon:

"Operatori Ekonomik është i obliguar të dorëzojë Autorizimin e Prodhuesit (Manufacturer Authorization Form - MAF) për të gjitha produktet e ofertuara në kuadër të sistemit të zërit (Sound System) dhe sistemit të konferencave (Conference System)."

Kjo kërkesë është diskriminuese, joproporcionale dhe kufizon rëndë konkurrencën.

Autorizimi i prodhuesit (MAF) nuk paraqet kriter ligjor për dëshmimin e kapacitetit profesional dhe teknik të operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik mund të sigurojë furnizimin e produkteve:

- përmes distributorëve të autorizuar;
- përmes partnerëve tregtarë;
- përmes zinxhirit të rregullt të furnizimit;
- përmes importuesve dhe shitësve të autorizuar.

Kërkesa për MAF përjashton në mënyrë të panevojshme operatorët ekonomikë që posedojnë:

- përvojë profesionale;
- kapacitet teknik;
- kapacitet financiar;
- aftësi për realizimin e kontratës.

Në praktikë, prodhuesit lëshojnë autorizime vetëm për një numër të kufizuar partnerësh, ndërsa shumë operatorë ekonomikë që mund të realizojnë kontratën në mënyrë profesionale nuk kanë qasje në marrjen e

MAF-it.

Për rrjedhojë, kjo kërkesë:

- zvogëlon numrin e ofertuesve potencialë;
- kufizon konkurrencën e lirë;
- rrit rrezikun e favorizimit të operatorëve të caktuar ekonomikë;
- bie ndesh me nenin 7 të LPP-së;
- bie ndesh me nenin 28 të LPP-së;
- bie ndesh me nenin 65 të LPP-së;
- bie ndesh me nenin 25.6 të Rregullores Nr.001/2022.

Në praktikën e OSHP-së dhe sipas parimeve të prokurimit publik, Autoriteti Kontraktues nuk duhet të kërkojë autorizime të prodhuesit nëse qëllimi i njëjtë mund të arrihet përmes mjeteve më pak kufizuese.

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë:

- deklaratë të garancisë;
- dëshmi për origjinën e produkteve;
- deklaratë për mbështetjen teknike;
- deklaratë për sigurimin e pjesëve rezervë dhe servisimit.

Prandaj, kërkesa për MAF për të gjitha produktet e sistemit të zërit dhe sistemit konferencial nuk është e domosdoshme dhe paraqet kriter diskriminues që cenon konkurrencën.

FAVORIZIMI I NJË OPERATORI EKONOMIK

Kumulimi i të gjitha kërkesave:

- certifikimi për punë në lartësi;
- certifikimi AME;
- Licenca A;
- Lead Auditor;
- SIMZ;
- certifikimet e prodhuesve;
- kërkesa për MAF;
- numri i madh i certifikimeve ISO;

krijon një profil të personalizuar të operatorit ekonomik që në praktikë mund të përmbushet vetëm nga një ose shumë pak operatorë ekonomikë.

Kjo krijon dyshim serioz dhe të bazuar se dosja e tenderit është hartuar në mënyrë të tillë që t'i përshtatet një operatori ekonomik të caktuar dhe jo për të garantuar konkurrencë të hapur dhe efektive, siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik.

PROPOZIMI PËR PANELIN SHQYRTUES TË OSHP-SË

Duke u bazuar në nenet 1, 7, 28, 65, 69 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 25 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, i propozojmë Panelit Shqyrtues që:

TA APROVOJË ANKESËN SI TË BAZUAR;

TA ANULOJË VENDIMIN REFUZUES TË AUTORITETIT KONTRAKTUES;

TË KONSTATOJË

se kriteret e kontestuara janë joproportionale, diskriminuese dhe nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës;

TË URDHËROJË AUTORITETIN KONTRAKTUES:

1. Të largojë kërkesën për certifikim për punë në lartësi për Menaxherin e Projektit;
2. Të largojë kërkesën për certifikim AME për mbrojtje nga zjarri;
3. Të largojë kërkesën për certifikim Lead Auditor;
4. Të rishikojë dhe reduktojë kërkesat kumulative për personelin profesional;
5. Të largojë kërkesat për ISO 20000-1 dhe ISO 50001;
6. **Të largojë kërkesën për Manufacturer Authorization Form (MAF) për produktet e sistemit të zërit dhe sistemit të konferencave, pasi kjo kërkesë kufizon konkurrencën, favorizon operatorë të caktuar ekonomikë dhe nuk është e domosdoshme për realizimin e kontratës;**
7. Të harmonizojë Dosjen e Tenderit me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave, me qëllim krijimin e konkurrencës së lirë, efektive dhe jodiskriminuese ndërmjet operatorëve ekonomikë.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Mosrespektimi i dispozitave të LPP-së i shkakton operatorit ekonomik:

- pamundësi reale për pjesëmarrje në procedurë;
- humbje të mundësisë për konkurrim të barabartë;
- dëmtim ekonomik dhe reputacional;
- cenim të besimit të operatorëve ekonomikë në sistemin e prokurimit publik.

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e

Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si ne pergaditjen e kerkesave per rishqyrtim ashtu edhe per pergaditjen e ankeses.

Dëmi refletkon në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
- *I...T&C...@E.....C*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*